



Ndërtesa e Elektrokosovës Elektrokosova Building  
Bulevardi Bill Klinton nr.5 Bill Clinton Bulevard no.5  
Prishtinë 10000 Prishtina 10 000  
Republika e Kosovës Republic of Kosovo



KOMPANIA KOSOVARE PËR DISTRIBUIM DHE FURNIZIM ME ENERGIJE ELEKTRIKE SH.A.  
KOSOVO ELECTRICITY DISTRIBUTION AND SUPPLY COMPANY J.S.C.  
KOSOVSKU PRIDRUŽJE ZA DISTRIBUCIJU I SNABEVAJE ELEKTRIČNOM ENERGIJOM D.D.

**KEDS - SH. A.**

Nr. 10 Dt. 22. 1. 2024  
HQI

**Ymer Fejzullahu**  
Kryesues i Bordit të ZRRë-së

**Alpin Dogan**  
Kryeshef Ekzekutiv  
KEDS sh.a.

**22 janar 2024**

## **Lënda: Aplikimi për të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin 2024**

I nderuar zt. Fejzullahu,

Përmes kësaj letre po ju dërgojmë Aplikimin për të Hyrat e Lejuara Maksimale të përgatitur nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSh) për vitin 2024. Ky Aplikim është përgatitur në përputhje me Rregullën për të Hyrat e Lejuara Maksimale të Operatorit Sistemit Shpërndarjes (Rregulla për të Hyrat e OSSH) dhe njoftimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRë) të datës 12.12.2023, për hapjen e procesit për përshtatjet vjetore të të hyrave dhe tarifa për vitin 2024.

OSSH mbetet e përkushtuar për të bashkëpunuar me qëllim që të arrihen konkluzione të përbashkëta e të cilat janë në interes të të gjitha palëve pjesëmarrëse në sektorin e energjisë.

Me respekt,

**Alpin Dogan**  
Kryeshef Ekzekutiv, KEDS sh.a.





Ndërtesa e Elektrokosovës  
Bulevardi Bill Klinton nr.5  
Prishtinë 10000  
Republika e Kosovës

*Elektrokosova Building  
Bill Clinton Bulevard no.5  
Prishtina 10000  
Republic of Kosovo*



# Aplikimi i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin 2024

Janar, 2024



## Përmbajtja:

1. Hyrje .....	3
2. Kostot operative dhe të mirëmbajtjes (OPEX).....	3
3. Kostot e zhvlerësimit dhe kthimit .....	6
4. Kostoja e humbjeve.....	7
5. Jo balancat e OSSH-së .....	9
6. Kostot tjera.....	10
6.1 Të hyrat e parregulluara .....	10
6.2 Obligimet ndaj Operatorit të Tregut dhe Operatorit të Sistemit Transmisionit .....	11
6.3 Obligimet ndaj ALPEX.....	12
7. Faktori korigjues i të hyrave – KREV .....	12
8. Të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2024.....	13



## 1. Hyrje

KEDS i licencuar si Operator i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) ka përgatitur Aplikimin për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për vitin 2024, në përputhje me Shtojcën 7 të Rregullës për të Hyrat e Lejuara Maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për të hyrat e OSSH-së) dhe letrës zyrtare të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të pranuar më 12 dhjetor 2023.

Ky aplikim përfshin gjitha të dhënat e kërkuar dhe të nevojshëm sipas Rregullës për të Hyrat e OSSH-së, si dhe përfshinë gjitha shpenzimet e arsyeshme me qëllim të funksionimit dhe operimit të duhur të sistemit shpërndarjes dhe ofrimin më të mirë të shërbimeve për gjithë konsumatorët.

Gjatë vitit 2022, ZRRE ka aprovuar parametrat kryesor për periudhën e tretë rregullative (2023-2027), prandaj Operatori i Sistemit të Shpërndarjes në këtë aplikim ka përditësuar këto të dhëna në përputhje me Rregullën për të Hyrat e OSSH-së.

Duke qenë se procesi tarifar është interaktiv ndërmjet ZRRE-së dhe të licencuarve të tjerë, ky aplikim mund të përshtatet tutje me qëllim të reflektimit të kostove që janë të ndërlidhura me të licencuarit e tjerë.

Kapitujt vijues japin shpjegimet dhe arsyetimet e nevojshme për të gjitha kostot e kërkuara, të cilat janë të domosdoshme për operimin e duhur të sistemit të shpërndarjes.

## 2. Kostot operative dhe të mirëmbajtjes (OPEX)

Bazuar në nenin 9 të Rregullës për të hyrat e OSSH-së, kostot operative dhe të mirëmbajtjes së OSSH-së, që i atribuohen licencës së OSSH-së, mbulohen përmes të Hyrave të Lejuara Maksimale për vitin e ardhshëm relevant.

ZRRE gjatë vitit 2022, përmes shqyrtimit periodik ka përcaktuar kostot operative dhe të mirëmbajtjes për periudhën 2023-2027, të cilat janë përcaktuar si vazhdimësi e kostove operative dhe të mirëmbajtjes të periudhës së dytë rregullative. OSSH edhe gjatë procesit të përcaktimit të këtyre kostove ka argumentuar se ka rritje të shpenzimeve operative përgjatë viteve, mirëpo ZRRE gjatë shqyrtimit të parametrave shumëvjeçar ka marrë për bazë vetëm të dhënat historike. ZRRE nuk i ka marrë në konsideratë të dhënat faktike dhe respektivisht ka lejuar nivele më të ulëta të kostove operative dhe të mirëmbajtjes, duke e rrezikuar mbarëvajtjen e operimeve të OSSH-së për pesë vitet e ardhshme.



Duke marrë për bazë faktin se numri i konsumatorëve aktiv rritet për rreth 25,000 konsumatorë në baza vjetore, nevoja për të ofruar shërbime sa më cilësore rritet gjithnjë e më shumë. Cilësia e ofrimit të shërbimeve nga OSSH pa dyshim që ka kosto të lartë marrë parasysh se kërkohen programe specifike dhe të specializuara të sistemit operativ. Nga 470,000 konsumatorë aktiv në vitin 2013, numri është rritur në mbi 700,000 konsumator aktiv në vitin 2023, e cila ka rezultuar edhe me rritjen e shpenzimeve për ofrimin e shërbimeve për këta konsumatorë.

Nga ana tjetër, pagat e punonjësve nuk janë të harmonizuara me pagat e operatorëve të tjerë të sektorit të energjisë në Kosovë, çfarë është duke i shkaktuar OSSH-së me largim të vazhdueshëm të punëtorëve profesional dhe mungesë të interesimit për punësim gjatë hapjes së konkurseve. Largimi dhe përgjithësisht mungesa e punëtorëve profesional pritet të rritet edhe më shumë nga janari i vitit 2024, si shkak i liberalizimit të vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës.


Një studim i bërë nga Instituti Riinvest<sup>1</sup> tregon se që nga vitit 2016, rreth 1% e popullsisë së Kosovës ka emigruar drejt Gjermanisë me leje pune, apo rreth 12,000 individë në moshë pune. Sipas Raportit, bizneset kanë raportuar se 17.59% e punëtorëve të tyre tashmë i kanë informuar bizneset se do të emigrojnë gjatë vitit 2024, ndërsa pritshmëria e bizneseve është se 32.72% e punëtorëve pritet të emigrojnë. Këtë e mbështet edhe anketa e realizuar në KEDS, ku rreth 30% e punëtorëve kanë shprehur interesim për emigrim, 6% prej tyre në fillim të vitit, ndërsa 24% përgjatë vitit 2024.

Raporti “Ndikimi i liberalizimit të vizave në tregun e punës në Kosovë” e punuar nga EPPC tregon se 60% do të jetë ndikimi i liberalizimit në kompanitë kosovare, ndërsa në tregun e punës liberalizimi do të ketë ndikim prej 87%. Përkatësisht, 22% do të jetë me i lartë qarkullimi i stafit, ndërsa 40% do të ketë rënie të aplikuesve të rinjë në vende të punës dhe 64% do të rritet kërkesa për rritje të pagave nga punonjësit aktual, si rezultat i rritjes së ngarkesës në punë.

Nga konkluzionet e anketës së KEDS lidhur me arsyet e migrimit, arsyeja kryesore mbetet paga më e mirë, e cila mbështet edhe me të gjeturat e raporteve të EPPC-së, në të cilën kushtet financiare dhe mirëqenia janë renditur në top tri arsye kryesore shtytëse për emigrim.

---

<sup>1</sup> Instituti Riinvest, Nëntor 2023 “Një model i i për rritjen e qëndrueshme ekonomike. Dinamika e tregut të punës: sfidat aktuale dhe të ardhshme”, linku: [https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2023/November/13/19\\_-\\_Forumi\\_Ekonoik\\_Vjetor\\_-\\_ALB021699882724.pdf](https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2023/November/13/19_-_Forumi_Ekonoik_Vjetor_-_ALB021699882724.pdf) (data e qasjes 03.01.2024)



Bazuar në Raportin e Institutit Riinvest, bizneset gjatë vitit 2023 veçse kanë filluar t'i rrisin pagat e punëtorëve. Rreth 79% e bizneseve kanë rritur pagat e punëtorëve, me një rritje mesatare mbi 22 % të pagës. Për më tepër, raporti thekson se mbi një e treta e këtyre bizneseve raportojnë se do të vijojnë t'i rrisin pagat edhe më tej.

Së fundmi kemi parë që edhe në sektorin e energjisë janë ndërmarrë hapa për rritjen e pagave të punëtorëve, ku KEK - Gjenerimi në fund të vitit 2023, rriti sërish pagat për afro 15%, duke rritur edhe më shumë dallimin ndërmjet punëtorëve të të njëjtit sektor. Ky dallim po i demotivon punëtorët profesional duke i detyruar ata të lëvizin kundrejt kompanive private, KEK dhe KOST, paga mesatare e të cilëve është dukshëm më e lartë.

Përderisa OSSH është kompani e rregulluar, shpenzimet operative të të cilit janë zvogëluar ndër vite dhe për më shumë në shpenzimet operative ka të aplikuar edhe faktorin e efikasitetit të përcaktuar nga ZRRE, mundësia e OSSH-së për rritjen e pagave është pothuajse e pamundur në këto rrethana. Andaj, marrë parasysh si më lartë, me qëllim të frenimit të trendit të migrimit, sigurimit të stabilitetit dhe qëndrueshmërisë operative, OSSH propozon një rritje të pagave prej 15% për vitin 2024, e cila do të ndihmojë operatorin të jetë në gjendje të mbajë një fuqi punëtore kompetente dhe të kualifikuar.

Është e rëndësishme të theksohet se gjatë vitit 2023 është nënshkruar marrëveshja me furnizuesin Elektroserver për furnizimin e 4 komunave në Veriun e Republikës së Kosovës. OSSH aktualisht është në fazën e mbledhjes së të dhënave nga terreni, mirëpo nga vlerësimet paraprake ne kemi përfshirë një kosto fillestare për shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për atë zonë.



### 3. Kostot e zhvlerësimit dhe kthimit

Plani i Investimeve i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes është i dizajnuar për të mundësuar furnizim të sigurt dhe të besueshëm të energjisë elektrike me një çmim të arsyeshëm, e njëkohësisht për të siguruar funksionimin e rrjetit në mënyrë transparente dhe në përputhje me parimet komerciale.

Rritja e shpejtë e kërkesës për energji është duke mbingarkuar vazhdimisht daljet ekzistuese si rezultat i zhvillimeve të reja, duke arritur kështu në limitin e kapaciteteve maksimale të linjës. Prandaj, OSSH gjatë hartimit të planit investuese për vitet 2023-2027, kishte marrë për bazë kriteret si: ngarkesën e rrjetit, rënien e tensionit, humbjet, indeksat e ndërprerjeve, kërkesën total në terma të energjisë, rritjen e konsumit, vjetërsinë e rrjetit dhe numrin e konsumatorëve.

Në mars të vitit 2023 përmes vendimit nr.V\_1711\_2023, ZRRE aprovoi Planin e investimeve për periudhën e tretë rregullative në një total prej 122.07 milion €, ndonëse propozimi i OSSH-së për pesëvjeçarin e ardhshëm ishte 166.87 milion € investime, marrë parasysh kriteret e lartpërmendura dhe investimet e nevojshme drejt rehabilitimit të rrjetit për të përshtatur me nevojat gjithnjë në rritje të BRE-ve.

Përkundër faktit se ZRRE aprovoi një numër më të vogël të investimeve në rrjet dhe një mesatare të ponderuar të kostos të kapitalit shumë të ultë, OSSH ka arritur të realizoj planin e investimeve për vitin 2023 me qëllim të përshtatjes së rrjetit të shpërndarjes me nevojat e konsumatorëve. Sidoqoftë, për shkak të numrit të ultë të njehsorëve të njohura në Planin Investiv 2023-2027, gjatë vitit 2023 OSSH kishte vështirësi në arritjen e caqeve për verifikimin dhe ndërrimin e njehsorëve, siç përcaktohet në Ligjin e Meteorologjisë, për çfarë OSSH ka pranuar gjobë nga inspektorati i Institutit të Meteorologjisë. Marrë në konsideratë se OSSH është kompani e licencuar, të hyrat e të cilit përcaktohen nga ZRRE-ja, është e papranueshme të mos njihet kostot e arsyeshme për njehsor, me qëllim të përmbushjes së kërkesave ligjore. Në këtë kuptim, OSSH tashmë ka dorëzuar për aprovim në ZRRE kërkesën për rritjen e numrit të njehsorëve në planin investiv dhe presim që e njëjta të aprovohet nga ZRRE. Duke marrë parasysh se kjo kërkesë ka bazë ligjore, të njëjtat tashmë janë përfshirë në këtë aplikim.

Viti 2023 u karakterizua edhe me një ngjarje të rëndësishme në fushën e energjisë elektrike, përkatësisht u nënshkrua marrëveshja me furnizuesin Elektroserver për furnizimin e 4 komunave në Veriun e Kosovës. Kjo marrëveshje njëherazi i jep qasje OSSH-së të operoj në atë zonë, por njëkohësisht nënkupton edhe nevojë për investime shtesë nga OSSH-ja, të cilat nuk janë të njohura në planin e aprovuar të investimeve për periudhën e tretë rregullative (2023-2027).





Meqenëse marrëveshja është në fuqi nga 1 janari 2024, OSSH është në fazën e mbledhjes së të dhënave nga terreni mbi gjendjen ekzistuese, në bazë të cilës do të hartohet plani i detajuar për investimet e domosdoshme në 4 komunat e veriut. Sidoqoftë, në këtë aplikim kemi paraparë një investim fillestar, i cili është i domosdoshëm për të filluar operimet, siç janë kostot për ndërrimin e njehsorëve, rehabilitimin, zgjerimin e rrjetit, etj. Kostot e parapara për instalimin e njehsorëve përfshijnë vetëm njehsorët që do të instalohen në fazën e parë, ndërsa kostot e parapara për fazën e dytë nuk janë përfshirë në këtë aplikim pasi që nga diskutimet me akterët tjerë të përfshirë në këtë proces të njëjtat priten të financohen nga Bashkimi Evropian. Megjithëkëtë nëse këto kosto nuk mbulohen ashtu siç është diskutuar, të njëjtat duhet të përfshihen në të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2024, meqenëse janë domosdoshmëri drejt normalizimit të furnizimit dhe faturimit në atë zonë.

Në këtë aplikim OSSH ka shfrytëzuar nivelin e aprovuar të investimeve gjatë periudhës së tretë rregullative, përfshirë investimet shtesë për 4 komunat veriore dhe njehsorët elektrik të argumentuar si më sipër, dhe në përputhje me Rregullën për të Hyrat e OSSH-së, janë llogaritur kostot e zhvlerësimit dhe kthimit për vitin 2024, të cilat marrin parasysh edhe përshtatjen e kostove të lejuara gjatë vitit 2023 për normën e inflacionit.

#### **4. Kostoja e humbjeve**

Sipas nenin 12 të Rregullës për të Hyrat e OSSH-së, OSSH është përgjegjës për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes. Kostoja e lejuar e humbjeve është kostoja e parashikuar e humbjeve që do të mbulohet nga OSSH për të kompensuar humbjet në sistemin e shpërndarjes dhe do të llogaritet duke përdorur nivelin e lejuar të humbjeve që caktohet gjatë shqyrtimeve periodike. ZRRE përmes vendimit nr. V\_1636\_2022, ka aprovuar cakun e reduktimit të humbjeve për periudhën e tretë rregullative 2023-2027, e cila si e tillë është aplikuar gjatë kalkulimit të kostove për nivelin e lejuar të humbjeve për vitin 2024.

Parashikimi i volumeve për kalkulimin e kostos së humbjeve është bërë në bazë të draft bilancit të energjisë elektrike për vitin 2024 dhe komenteve të KEDS dërguar me dt. 15.12.2023 e cila merr për bazë edhe rrjedhën e energjisë dhe nivelin e humbjeve për 4 komunat në veri. Marrë parasysh që për humbjet në pjesën veriore, nuk është përcaktuar asnjë nivel i humbjeve, të njëjtat duhet të njihen si të realizuara. Sidoqoftë, për qëllime të aplikim tarifor, niveli i humbjeve për pjesën veriore është parashikuar bazuar në informatat preliminare të pranuar nga Elektroserveri dhe të njëjtat duhet të përshtaten varësisht nga realizimet.

Në përputhje me udhëzimin e ZRRE-së të lëshuar në mars të vitit 2017, gjenerimi i KEK alokohet fillimisht tek Furnizuesi i Shërbimit Universal, dhe pjesa tjetër ndahet proporcionalisht ndërmjet KEDS dhe KOSTT për mbulimin e humbjeve të shpërndarjes dhe transmetimit. Me 29 dhjetor 2023, KEDS ka pranuar shkresë zyrtare nga KEK-Gjenerimi ku propozohet çmimi i blerjeve nga





OSSH në 39.10 €/MWh për periudhën 01.04.2024-31.03.2025. Sipas shkresës së pranuar, kjo rritje e çmimit vjen si rrjedhojë e rritjes së tarifave të KOSTT përgjatë periudhës 2021-2023 dhe rritjes së inflacionit, e cila ka ndikuar në rritjen e kostos së prodhimit të energjisë elektrike.

Pa paragjykuar arsyeshmerinë e ofertës, me aplikimin e çmimeve të propozuar nga KEK kostot e OSSH-së rriten për 1.2 milion €, apo një rritje prej 1% të MAR-it. Duke marrë parasysh që nuk kishte kohë të mjaftueshme për të negociuar dhe respektivisht për të arritur një marrëveshje, OSSH në këtë aplikim ka paraparë për blerjet nga KEK çmimin aktual konform Shtojcës 8 të Marrëveshjes së BSA-së. Sidoqoftë, marrë parasysh lëvizjet e çmimeve në treg, OSSH mbetet e hapur për negociim nëse ZRRE vlerëson arsyeshmërinë e kërkesës, i cili duhet të jetë në interes dhe i pranueshëm për të gjitha palët e përfshira.

Parashikimi i volumeve për blerjet nga KEK është bërë në bazë të planit të prodhimit të KEK në draft bilancin e energjisë elektrike për vitin 2024, megjithëse OSSH është shprehur skeptik në planin e prodhimit, marrë parasysh realizimet historike të prodhimit të KEK, përkatësisht ndryshimet e prodhimit në mes të vitit. Kjo e fundit paraqet kosto shtesë operative përgjatë vitit për OSSH-në, marrë parasysh se mungesën e prodhimit të KEK duhet ta mbulojë përmes importit, e cila ka çmim shumë më të lartë, duke ndikuar dukshëm në koston e humbjeve.

Marrë parasysh se nga kriza energjetike, çmimet e importit përveç se janë më të larta, janë shumë volatile dhe vështirë të parashikueshme andaj parashikimi i drejtë i tyre, duke përfshirë edhe kostot për kapacitet janë të domosdoshme. Me qëllim që të sigurohet likuiditeti i mjaftueshme OSSH-ja në parashikimin e kostos së humbjeve për vitin 2024, ka përdorur çmimet e pritshme në bursat ndërkombëtare, duke aplikuar edhe kostot e kapacitetit, si kostot shtesë që aplikohet në çmimin përfundimtar.

Bazuar në të lartë thënat kostoja e parashikuar e humbjeve nga OSSH për vitin 2024 është 89.53 milion €, siç është paraqitur në tabelën më poshtë:

Inputet për kalkulim	Njësia	2024
Energjia që hyn në shpërndarje	GWh	6,301.39
Lejimi i humbjes	%	16.61%
Humbjet	GWh	1,046.67
Çmimi i blerjes	€/MWh	85.54
<b>Kostoja e humbjeve</b>	<b>mil€</b>	<b>89.53</b>



## 5. Jo balancat e OSSH-së

OSSH-ja është përgjegjës për sigurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve sipas parimeve të tregut të energjisë elektrike, transparencës dhe jo diskriminimit. Në të njëjtën kohë, OSSH është palë nënshkruese e marrëveshjes si Palë Përgjegjëse për Balancë (PPB), përmes së cilës zotohet që devijimet/jo balancat ndaj KOSTT-it dhe rrjedhimisht ndaj rrjetit të ENTSO-E t'i mbajë brenda vlerave minimale të mundshme.

Ngarkesa në sistemin e shpërndarjes, rrjedhimisht edhe humbjet e energjisë elektrike, varen nga faktorë të ndryshëm dhe parashikimit i tyre si: moti, sjellja e konsumatorëve, planet e mirëmbajtjes, prishjet eventuale, investimet dhe faktorë të tjerë. Marrë parasysh pamundësinë e parashikimi të konsumit, respektivisht humbjeve orë për orë, gjatë hartimit të Rregullave të Tregut me ndryshimin e Ligjeve të Energjisë gjatë vitit 2016/2017, është përcaktuar ndarja e humbjeve dhe furnizimit sipas koeficientit të humbjeve të parashikuara për muajin përkatës, e cila është e aplikueshme si e njëtrajtshme përgjatë gjithë orëve dhe ditëve në muajin respektiv.

Parashikimi i konsumit ka qenë dhe vazhdon të jetë sfidë që ndikohet nga struktura e konsumit ku pjesa më madhe është amvisëri. Kjo akoma bëhet më e vështirë kur shtohen furnizues të rinj. Prandaj në situatë të tillë jo balancat që shfaqen janë të pashmangshme dhe jodomosdoshmërisht shkaktohen nga ose i përkasin OSSH-së. Një horizont i tillë i parashikimit të humbjeve përmes koeficientit ndërmjet shumë furnizuesve nënkupton shkallë më të lartë të pasaktësisë, duke krijuar kështu kosto të panevojshme dhe jo-realiste në sistemin e energjisë elektrike.

Ngjarjet si nënshkrimi i marrëveshjes së fundit ndërmjet KEDS dhe Elektroserver (me të cilën parashihet që KEDS të merr përsipër mbulimin e humbjeve të shkaktuara në pjesën veriore të Republikës së Kosovës), hyrja e furnizuesve të rinj në treg dhe funksionalizimi i bursës ALPEX, janë pikërisht sfida që do të kenë implikime të theksuara në mënyrën se si do të menaxhoj OSSH-ja jo-balancat në sistem.

Mos operimi i KEDS në pjesën veriore të Republikës së Kosovës për një kohë të gjatë, si dhe fakti që konsumatorët e kësaj zone nuk kanë paguar fatura të energjisë elektrike për një kohë të gjatë, rrisin pasigurinë dhe seriozitetin e kësaj situatë.

Në anën tjetër, funksionalizimi i pritshëm i bursës ALPEX në Kosovë, pas fillimit të saj në Shqipëri, krijon rrezik shtesë. Kjo për faktin se nga rezultatet aktuale të tregutit në bursën ALPEX, shihet se ende nuk është arritur likuiditeti dhe fakti i bashkimit me Kosovën nuk është tregues se do ta bëjë atë më likuid se sa është tani. Pavarësisht se KEDS-i si OSSH ende nuk është anëtar i ALPEX-it, ekziston frika se edhe nëse i bashkohen ALPEX-it, kërkesa mund të mos plotësohet në mënyrë adekuate, duke pasur parasysh se OSSH siguron humbjet kryesisht nga prodhimi i KEK-ut dhe



pjesa tjetër në treg nga tregtarë të ndryshëm. Nga analizat e bëra vërehet se sasi të e mbetura nga bursa ALPEX vështirë se do të plotësojnë kërkesën tonë në kushte normale kur gjithçka funksionon sipas planit, duke mos përfshirë këtu edhe rënien e ndonjë njësie nga KEK gjenerimi.

Krahas mungesës së prodhimit të kapaciteteve shitëse, kufiri AL-KS do të përdoret për bashkim të tregut të një ditë para dhe kjo pritet të rëndoje edhe më tepër situatën. Gjatë seancave testuese të zonës së ofertave të ALPEX në Kosovë kemi vërejtur se nuk ka asnjë shitës madje edhe me sasi të e Burimeve të Ripërtitshme të FSHU-së çmimi rritet në 4000 EUR/MWh. Shtuar kësaj, edhe faktin që edhe KOSTT do të blejë për nevojat e tyre nga ALPEX por që kapaciteti nuk është i mjaftueshëm as për ata.

Për rrjedhojë, sa herë që OSSH nuk do të ketë mundësi të mbulojë kërkesën e saj në ALPEX, OSSH do të jetë e detyruar të gjejë një mënyrë për të siguruar pjesën tjetër brenda ditës (intraday) pasi procesi i ofertimit në bursat e tjera do të jetë tashmë i mbyllur. Duke ditur që sasi të e mbetura nga tregu i një dite para tregtohen brenda ditës në intraday dhe ka një probabilitet të lartë që energjia të mos sigurohet, i gjithë ky deficit energjetik do të reflektohet në jo balanca.

Duke marrë parasysh të lartë thënat, ne propozojmë që kostot e jo balancave nga viti 2024 e tutje të njihen nga ZRRE si kosto të arsyeshme, me synimin që ato të mbuloohen përmes tarifave. Ne jemi të hapur për të bashkëpunuar me ZRRE në vlerësimin e kushteve aktuale të sektorit të energjisë dhe ndryshimet e nevojshme rregullative, pasi që kjo qasje jo vetëm që vendos stabilitet financiar për OSSH-në në adresimin e sfidave të paparashikuara, por siguron edhe përmbushjen e përgjegjësisë tona si Palë përgjegjëse për balancim në tregun e energjisë elektrike. Për më tepër, kjo qasje do të kontribuojë në përmbushjen e obligimeve të Republikës së Kosovës si shtet ndaj ENTSO-E.

## **6. Kostot tjera**

Pjesë përbërëse e të hyrave të lejuara maksimale (MAR) janë gjithashtu të hyrat e parregulluara, obligimet ndaj Operatorit të tregut dhe operatorit të sistemit të transmetimit, si dhe çdo kosto tjetër e arsyeshme që ndërlidhet me ofrimin e shërbimeve të sistemit të shpërndarjes.

### **6.1 Të hyrat e parregulluara**

Gjatë përcaktimit të të hyrave të lejuara maksimale, ZRRE i zbrit të hyrat e realizuara nga shërbimet e përjashtuara, të cilat njihen si të hyra të parregulluara. Të hyrat e parregulluara të parashikuara në MAR-in e periudhës së tretë rregullative janë 5.41 milion € për vitin 2024, e të cilat janë përfshirë edhe në propozimin e OSSH-së për MAR-in e këtij viti.



Në këtë aplikim, përveç përshtatjes së të hyrave të parregulluara për vitin 2023 janë aplikuar edhe përshtatjet e të hyrave të parregulluara për vitin 2020-2022, konform të dhënave finale të prezantuara në pasqyrat financiare. Marrë parasysh se të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2021 dhe 2022 janë aprovuar si rrjedhojë e shqyrtimeve të jashtëzakonshme, dhe se gjatë këtyre proceseve pasqyrat financiare nuk kane qenë të audituara, prandaj dhe të dhënat për të hyrat e parregulluara janë paraqitur si të dhëna preliminare. Përshtatjet e aplikuar për këto vite janë në përputhje me faturat e lëshuara për këto shërbime dhe prezantimet në pasqyrat financiare të audituara, të cilat tashmë i janë dorëzuar ZRRE-së.

Është e rëndësishme të theksohet se gjatë viteve të kaluara ZRRE ka zbritur të gjitha të hyrat e parregulluara nga MAR-i i OSSH-së. Sidoqoftë, siç është argumentuar edhe më parë OSSH vazhdon të besojë se zbritja e të gjitha të hyrave të parregulluara nuk është e drejtë dhe nuk ofron nxitje për OSSH-në për rritjen potenciale të këtyre të hyrave. Për më tepër është e rëndësishme të theksohet se të hyrat aktuale nuk i mbulojnë dëmet që shkaktohen në rrjet nga operatorët, siç janë dëmtimet fizike të linjave dhe shtyllave të OSSH-së gjatë punimeve nga operatorët, si dhe ndikimi në jetëgjatësinë e aseteve të OSSH-së nga ngarkesa shtesë e linjave të operatorëve, por që për shkak të kontratave të trashëguara OSSH është obliguar të ofroj këto shërbime.

OSSH është e përkushtuar për të ruajtur standardet më të larta të shërbimit dhe pajtueshmërisë brenda kuadrit rregullativ. Në përputhje me këtë angazhim, ne kemi identifikuar edhe mundësi për të diversifikuar ofertat tona të shërbimeve jo-tarifore duke ofruar shërbime shtesë përtej atyre që tashmë zbriten nga MAR. Megjithatë, zbritja e plotë e këtyre të hyrave nga MAR, po ndikon edhe në uljen efektive të nxitjes për OSSH-në për të eksploruar dhe investuar në këto rrugë.

Për të adresuar këtë sfidë dhe për të nxitur inovacionin në sektor, ne propozojmë zbatimin e një faktori ndarës prej 50% mbi të ardhurat e krijuara nga këto shërbime shtesë. Ne besojmë se një faktor ndarjeje prej 50% arrin një ekuilibër të drejtë midis inkurajimit të inovacionit dhe përftimit të konsumatorit fundor, brenda pajtueshmërisë rregullative. Kjo qasje do të na mundësonte të përfitonim nga të hyrat shtesë të gjeneruara, duke kontribuar njëkohësisht në rritjen e përgjithshme dhe qëndrueshmërinë e ekosistemit të energjisë.

## **6.2 Obligimet ndaj Operatorit të Tregut dhe Operatorit të Sistemit Transmisionit**

Kostot e parashikuara për obligimet e OSSH-së ndaj Operatorit të Tregut dhe Sistemit Transmisionit për vitin 2024 janë 2.15 milion €. Këto kosto janë parashikuar në bazë të tarifave aktuale dhe humbjeve të parashikuara për vitin 2024. Çdo ndryshim në tarifatat e OST-së duhet të reflektohet nga ZRRE para përcaktimit të MAR-it përfundimtar për OSSH-në.



### **6.3 Obligimet ndaj ALPEX**

Zhvillimet e reja gjatë vitit 2023, të tilla si fillimi i operimit të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX) rezulton me kosto shtesë për OSSH-në. ZRRE përmes vendimit nr.V\_1766\_2023, ka aprovuara tarifën për periudhën tranzitore të Bursës shqiptare të energjisë elektrike ALPEX për zonën e ofertimit të Republikës së Kosovës, andaj në këtë aplikim OSSH ka paraqitur kostot e parapara sipas këtij vendimi.

## **7. Faktori korigjues i të hyrave – KREV**

Në pajtim me Rregullën për të Hyrat e OSSH-së, OSSH ka bërë korigjimin e të hyrave të vitit 2023, i cili aplikohet duke llogaritur dallimin ndërmjet vlerave të parashikuara për vitin tarifor 2023 dhe atyre të realizuara.

Në këtë kuptim, OSSH ka llogaritur MAR-in aktual dhe të hyrat e realizuara gjatë vitit 2023 dhe faktori korigjues ka rezultuar të jetë 13.81 milion € i cili duhet të reflektohet në MAR-in e vitit 2024.



## 8. Të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2024

Duke marrë parasysh të gjitha kostot e prezantuara në seksionet e mëparshme dhe në përputhje me formulën e dhënë në shtojcën 1 të Rregullës për të hyrat e OSSH-së, kërkesa për të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2024 është si vijon:

Te hyrat e lejuara maksimale-MAR	2024 (mil€)
Kostot Operative	33.80
Zhvlerësimi	20.78
Kthimi	17.60
Kostoja e humbjeve	89.53
Obligimet për OST-në	2.15
Të hyrat e parregulluara	(5.41)
Përshtatjet për të hyrat e parregulluara	3.78
Përshtatjet për PR2	0.09
Kostot për ALPEX	0.02
Faktori korigjues_KREV	(13.81)
<b>MAR</b>	<b>148.53</b>

Kërkesa e OSSH për të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2024 në vlerën prej 148.53 milion € siguron operim të qëndrueshëm të operatorit të sistemit të shpërndarjes, ofron shërbime më cilësore ndaj konsumatorëve dhe gjithashtu ruan stabilitetin financiar të OSSH-së. Çfarëdo tendence për të zvogëluar kërkesën e OSSH-së do të rrezikojë likuiditetin financiar të OSSH-së dhe qëndrueshmërinë e furnizimit me energji elektrike.